

DEKLARATË NËN BETIM

Sipas Nenit 19, paragrafit 4 dhe 6 të Politikës të Prokurimit të Fondit Kosovar për Garanci Kreditore, ofertuesit duhet të dorëzojnë të nënshkruar deklaratën nën betim me të cilën vërtetojnë se ata nuk gjenden në situatat e përmendura më poshtë.

Ofertuesi me nënshkrimin e kësaj deklarate nën betim vërteton se:

- Nuk janë në ndonjë procedurë të falimentimit apo të likuidimit, punët e tyre nuk administrohen nga gjykatat, nuk kanë hyrë në marrëveshje me kreditorët apo kanë ndërprerë aktivitet afariste, apo nuk ndodhen në situata të ngjashme të parapara me legjislacionin në fuqi;
- Nuk janë dënuar me aktgjykim të formës së prerë;
- Nuk kanë obligime të papërbushura lidhur me pagesën e kontributeve për sigurim social apo pagesën e taksave në përputhje me legjislacionin e vendit në të cilin janë themeluar apo ato të Kosovës;
- Nuk janë shpallur nga një gjykatë apo arbitrazh se kanë bërë shkelje serioze të kontratës si dështim për t'iu përmbajtur obligimeve të tyre kontraktuese pas një procedurë tjetër të tenderimit;
- Drejtuesit, personeli apo ndërmjetësit e tyre nuk janë subjekt i konfliktit të interesit;
- Nuk janë fajtorë për shpërdorim në ofrimin e informatave të kërkuara nga FKGK;
- Nuk kanë kontaktuar tenderuesit e tjerë me qëllim të kufizimit të konkurrencës;
- Nuk kanë histori të keqe kredie (klasa E ose më e ulët në Regjistrin e Kredive të BQK-së).

Data: ___ / ___ / _____

(Emri dhe Mbiemri)

(Nënshkrimi dhe Vula)

(Emri i kompanisë)